



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:083216

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05502069

**AC.nr. 8441/23**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Fatmir Baloku dhe Naim Mehulli-antarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. P. nga fshati L., Komuna O., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Sh.U. nga xxxx ndaj të paditurit Sh. M. R. ish nga fshati Ll., Komuna L., me objekt kontesti vërtetimi i të drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga paditësi përmes të autorizuarit të tij, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Fushë Kosovë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3140/20, të datës 08.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me data **25.03.2024** nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR** ankesa e paditësit A. P. nga fshati Lajthishtë/Komuna e O., ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat Sh. U. nga P., ndërsa, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Fushë Kosovë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.3140/2020, i datës 08.11.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Fushë Kosovë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar, C.nr.3140/2020, i datës 08.11.2023, ka vendosë si në vijim:

I. **NDËRPRITET** procedura në këtë çështje juridike kontestimore për shkak të vdekjes së të paditurit Sh. R., ish nga fshati Ll, Komuna e L.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të paditurit Sh. R. e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

Kundër këtij aktvendimi në afatin e përcaktuar ligjor ankesë ka ushtruar paditësi A. P. nga fshati L./Komuna e O., përmes të autorizuarit të tij, avokat Sh. U. nga P., për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike

dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ta prish Aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe lënda të kthehet në shkallën e parë për rishqyrtim dhe rivendosje, në gjykatën e shkallës së parë

Përgjigje në ankesë, nuk është ushtruar nga i padituri.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, shqyrtimit dhe analizimit të provave, e në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), konstatoi se:

**Ankesa e paditësit A. P. nga fshati L./Komuna e O., ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat Shemi Uka nga Prishtina rezulton e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësi A. P. përmes të autorizuarit të tij, avokat Sh. U. nga Prishtina ka ushtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë e në ngastrën lëndore të përshkruar si në petitum të padisë, së bashku me propozim për caktimin e masës së sigurimit, kundër të paditurit Sh. R. nga Obiliqi.

Gjykata e shkallës së parë, fillimisht duke vepruar sipas propozimit të paditësit për caktimin e masës së sigurimit, ka dërguar njoftimin me shkrim për dhënien e përgjigjes në propozimin për caktimin e masës së sigurimit së bashku me propozimin dhe shkresat e lëndës, kundërshtarit të masës së sigurimit-të paditurit Sh. R., me adresën e dhënë nga paditësi në O., rruga xxxx p.n, porse nga fletë kthesa e datës 24.07.2020 dhe ajo e datës 03.08.2020, rezulton se i padituri Sh. R. është i panjohur në këtë adresë, ashtu që, gjykata pas kësaj me aktvendimin e datës 17.08.2020, ka urdhëruar paditësin me plotësimin e padisë duke siguruar adresën e saktë për të paditurin, në paralajmërimin e pasojave për mos veprim, dhe paditësi me parashtresën e dorëzuar në gjykatë me datën 28.08.2020, përmes të autorizuarit të tij avokat Sh. U. nga P. e ka njoftuar gjykatën, mes tjerash se sa i përket adresës së banimit për të paditurin, paditësi ka vetëm këtë adresë dhe atë të nxjerrë nga kontrata mbi shitblerjen me të paditurin dhe nuk disponon me adresë tjetër të banimit për të njëjtin.

Gjykata ka caktuar seancën me datën 29.09.2020, mirëpo, edhe pse ka tentuar rishtas dërgimin e ftesës të paditurit në adresën e tij në xxxxxx, megjithatë konstatimi i postës i datës 21.09.2020, rezulton se i padituri është shpërngulë nga kjo adresë pa konfirmuar se ku ka shkuar, dhe gjykata ka shtyer seancën gjyqësore me detyrim për të paditurin që të gjej adresën e saktë për të paditurin, dhe paditësi me parashtresën e dorëzuar në gjykatë me datën 02.10.2020, e njofton gjykatën se edhe përkundër insistimeve maksimale nuk ka arritur të gjej adresën e banimit për të paditurin Sh. R., ku njëherit gjykatës i ka propozuar caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të njëjtin konform nenit 79 të LPK-së.

Në ndërkohë paditësi ka heq dorë nga propozimi për caktimin e masës së sigurimit, ashtu që, gjykata me aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi të datës 07.08.2023, të padituri i ka dërguar padinë me shkresat e lëndës që në afat prej 15 ditësh të jap përgjigje në padi, dhe ky aktvendim, të paditurit Sh. R. nga fshati Ll./Komuna e L. (tani me adresë të njohur për të njëjtin pas sigurimit të gjykatës nga Zyra e Gjendjes Civile në Fushë Kosovë), mirëpo, nga fletë kthesa e datës 23.08.2023, është konstatuar se i padituri ka vdekur, dhe gjykata me shkresën dërguar Zyrës së Gjendjes Civile në Fushë Kosovë, ka kërkuar të dhëna për vdekjen e të paditurit, nga ku gjykatës i është siguruar certifikata e vdekjes së të ndjerit Sh. R, ku i njëjti konstatohet se ka vdekur me datën 16.09.2023, dhe gjykata pas konstatimit të këtij fakti, nxjerr aktvendimin e

ankimuar për ndërprerjen e procedurës kontestimore për shkak të vdekjes së të paditurit bazuar në nenin 277 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e pranon të drejtë dhe të ligjshëm, aktvendimi i ankimuar, nuk është i shoqëruar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par.2, pika b), g), j), k) dhe m të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuese, dhe se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht.

Gjykatës së Apelit i rezultojnë të pa bazuara pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës së gjykata e shkallës së parë është dashtë të caktoj përfaqësuesin e përkohshëm për të paditurin dhe të vazhdoj procedurën kontestimore me vendosje meritore në këtë çështje juridike, për faktin se në bazë të nenit 277 par.1, pika a) të LPK-së, përcaktohet ndërprerja e procesit kontestimor për palën ndërgjyqëse që vdes, e humbë zotësinë procedurale dhe nuk ka përfaqësues me prokurë në gjykim, ku në rastin konkret i padituri konstatohet se ka vdekur dhe nuk shihet se ka pas të angazhuar përfaqësues me autorizim, ndërsa lidhur me caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të njëjtin, në parim palës që ka ndërruar jetë nuk mund ti caktohet përfaqësuesi i përkohshëm konform nenit 79 të LPK-së, megjithatë, palës paditëse posa të sigurohen të dhënat personale për trashëgimtarët e rendit të parë, të dytë ose të tretë ligjor e eventualisht edhe të katërt (komuna si trashëgimtare ligjore), detyrim ky që përveç që është i palës paditëse, njëkohësisht sipas kërkesës së palës paditëse është detyrim edhe i gjykatës që përmes të dhënave të siguruar nga Zyra e Gjendjes Civile në Fushë Kosovë apo në Lipjan(ku rezulton se i padituri kishte pranuar ftesat dhe kishte adresë të banimit), konform nenit 282 par.3, mund të vazhdohet procedura e ndërprerë kontestimore, sapo të sigurohen të dhënat e trashëgimtarëve ligjor të të paditurit, të njëjtit mund të përfshihen si palë ndërgjyqëse edhe pa u bërë shqyrtimi i masës trashëgimore për të ndjerin apo nëse të njëjtit rezultojnë me adresa të banimit në botën e jashtme apo të panjohur konform nenit 79, në lidhje me nenin 282 par.3 të LPK-së, mund t’iu caktohet përfaqësuesi i përkohshëm nga radha e avokatëve, megjithatë nën rrethanat aktuale, procedura e ndërprerë trashëgimore nuk mund të vazhdohet me caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për trashëgimtarët e palës së vdekur të cilët nuk janë të njohur me të dhënat personale të tyre dhe adresat e banimit, prandaj, mbi bazën e të gjitha këtyre arsyeve, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka ndërprerë procedurën kontestimore për shkaqe objektive (vdekjes së të paditurit), dhe pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës rezultojnë të pa bazuara.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e nenit 194, 208 dhe 209, pika (b), të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**AC.nr.8441/2023, dt:25.03.2024**

**Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari**  
**Besnik Feka**